REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr.21, datë 26.12.2023

## PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GODINË POLIFUNKSIONALE 2 – 33 KATE MBITOKË ME 4 KATE PARKIM NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja "ç", 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Fusha" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Godinë polifunksionale 2 – 33 kate mbitokë me 4 kate parkim nëntokë", me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Fusha" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:

   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**ADELAJDA ROKA**

Nënshkruar më datë 10/06/ 2024